



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri, më datën 21.11.2022, merr këtë

## V E N D I M

### **Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e shiut të datës 20.11.2022 në territorin e Komunës së Pejës**

- I. Formohet komisioni për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e shiut të datës 20-21 Nëntor 2022 në Komunën e Pejës, në këtë përbërje:
  - 1.1 Gzim Gashi kryesues i Komisionit
  - 1.2 Tahir Shala, anëtar
  - 1.3 Shemsedin Abazi, anëtar
  - 1.4 Idriz Selmanaj, anëtar
  - 1.5 Ilir Lulaj, anëtar
- II. Komisioni si në piken I të këtij vendimi ka për detyrë që të konstatojë dhe vlerësojë dëmet e shkaktuara në amvisëri, ekonomi familjare dhe infrastrukturën e përgjithshme komunale në tërësi të territorin e Komunës së Pejës ku ka pasur vërshime nga shiu i datës 20-21 Nëntor 2022.
- III. Obligohet komisioni në piken I të këtij vendimi që këto punë të kryej duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
- IV. Komisioni të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi.
- V. Komisioni ka për obligim që për punën e kryer të hartoj një raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe një ekzemplar në Arkiv të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Kryesuesit dhe anëtarëve të komisionit
- Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim
- Arkivit

I.nr. 42-02/121096 / 2022  
Pejë, 21 Nëntor 2022

